



UNMIK/REG/2005/14
16 mars 2005

RREGULLORE NR. 2005/14

PËR TAKSËN RRUGORE TË AUTOMJETEVE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/15 të datës 15 tetor 1999 mbi regjistrimin e përkohshëm të automjeteve private në Kosovë,

Në përputhje me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke vepruar me kërkesë të Qeverisë dhe pas konsultimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Me qëllim të themelimit të taksës rrugore për automjete,

Shpall si në vijim:

Neni 1 Përkufizimet

Në këtë Rregullore:

(a) “Person përgjegjës” do të thotë personi, në emrin e të cilit është regjistruar automjeti apo në emrin e të cilit automjeti kërkohet të regjistrohet sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/15 të datës 15 tetor 1999;

(b) “Automjet i regjistruar” do të thotë cilido automjet, i cili është i regjistruar nga Njësia për regjistrimin e automjeteve e Ministrisë së Shërbimeve Publike sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/15 të datës 15 tetor 1999;

(c) “Rrugë të Kosovës” do të thotë cilado rrugë, shteg apo vendparkim në Kosovë, i cili është i hapur për qytetarët dhe

(d) “Automjet” do të thotë cilado formë e transportit me fuqi motorike, duke përfshirë veturat, kombibusët, automjetet për shërbime komunale, minibusët, autobusët, kamionët, traktorët dhe rimorkiot, por që nuk përfshijnë automjetet e liruara nga taksa të cekura në shtojcën A.

Neni 2

Taksa rrugore për automjete

2.1 Një taksë vjetore, e cila do të quhet taksa rrugore për automjete (më tutje në tekst “taksa”), vihet për të gjitha automjetet e regjistruara.

2.2 Shuma e taksës që do të vihet në përputhje me nenin 2.1 do të jetë aq sa është përcaktuar në shtojcën B.

2.3 Taksa është nën kontrollin dhe menaxhimin e Administratës tatimore të Kosovës.

Neni 3

Vjelja e taksës rrugore

Taksa do të vilet nga Njësia për regjistrimin e automjeteve e Ministrisë së Shërbimeve Publike në emër të Administratës tatimore të Kosovës me rastin e regjistrimit vjetor të automjetit dhe do të deponohet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 4

Dëshmia e pagesës dhe kontrolli

4.1 Pagesa e taksës dëshmohet me një vërtetim standard të pagesës (më tutje në tekst “vërtetim”) të lëshuar nga Njësia për regjistrimin e automjeteve. Ky vërtetim përmban datat e lëshimit dhe të skadimit të tij, si dhe numrin e regjistrimit të tabelave të automjetit.

4.2 Vërtetimi vendoset në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit të përparmë të automjetit.

4.3 Drejtuesi apo, nëse automjeti nuk drejtohet, personi përgjegjës, i cilitdo automjet të regjistruar që gjendet në rrugët e Kosovës, dhe i cili nuk e tregon vërtetimin e vlefshëm

ashtu siç parashihet në nenin 4.2, është përgjegjës për pagesën e tarifës administrative në shumë prej 100 euro.

4.4 Drejtuesi apo, nëse automjeti nuk drejtohet, personi përgjegjës, i cilitdo automjet të regjistruar ose i cilitdo automjet që kërkohet të regjistrohet, që gjendet në rrugët e Kosovës, dhe i cili nuk dëshmon lëshuarjen e vërtetimit të vlefshëm në pajtim me nenin 4.1, është përgjegjës për pagesën e një tarife administrative në shumë prej 500 euro.

4.5 Tarifa administrative sipas neneve 4.3 dhe 4.4 mund të shqiptohet nga Shërbimi Policor i Kosovës, Policia Kufitare e Kosovës apo nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, të cilët e informojnë Njësinë për regjistrimin e automjeteve përkitazi me tarifën e shqiptuar.

4.6 Njësia për regjistrimin e automjeteve do të refuzojë regjistrimin e cilitdo automjeti, për të cilin nuk është paguar tarifa administrative e shqiptuar sipas neneve 4.3 ose 4.4.

Neni 5 Lirimet nga taksa

Automjetet në listën e shtojcës A lirohen nga pagesa e taksës.

Neni 6 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 mars 2005, me përjashtim të nenit 4, dispozitat e të cilit hyjnë në fuqi pas futjes në qarkullim të vërtetimit në datën që do të caktohet me një urdhëresë administrative.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA A
AUTOMJETET E LIRUARA NGA TAKSA

1. Traktori bujqësor, nëse është traktor i disenjuar dhe i prodhuar vetëm për qëllime bujqësore, hortikulturale, pylltare dhe të prerjes së thuprave, të shkurreve dhe të drunjëve.
2. Automjeti i lehtë bujqësor, nëse:
 - (a) Peshon, pa karburant dhe vaj, më pak se 1,000 kilogramë;
 - (b) Është i disenjuar dhe i prodhuar për të zënë vetëm një drejtues dhe
 - (c) Është i disenjuar dhe i prodhuar vetëm për qëllime përkitazi me bujqësinë, hortikulturën dhe pylltarinë.
3. Makina për kositje.
4. Makina për pastrimin e borës.
5. Makina për hedhje, nëse është e prodhuar dhe e përshtatur vetëm për makinerinë e hedhjes së materialeve në rrugët e ngrira dhe rrugët me akull a me borë (me artikujt apo materialet e përdorura për qëllime të makinerisë apo pa to).
6. Vinçi lëvizës, nëse është i disenjuar dhe i prodhuar vetëm si vinç lëvizës.
7. Makina mihëse, nëse është e disenjuar dhe e prodhuar për qëllim të mihjes së kanaleve apo të cilësdo pune të gropimit a të heqjes me lopatë.
8. Automjeti për ndërtimin e rrugëve, nëse është i prodhuar ose i përshtatur për përdorim më të lehtë të makinerisë së montuar për ndërtimin e rrugëve (me artikujt apo materialet e përdorura për qëllime të makinerisë apo pa to).

Në këtë paragraf “makineria e montuar për ndërtimin e rrugëve”, lidhur me automjetin, do të thotë makineria për ndërtimin e rrugëve e montuar si pjesë e automjetit apo e fiksuar në mënyrë të përhershme për automjetin dhe “makineria për ndërtimin e rrugëve” do të thotë makina apo mjeti i përshtatshëm për ndërtimin e apo riparimin e rrugëve.
9. Makina për rrafshimin e rrugës.
10. Cilido automjet për të cilin janë paguar të gjitha taksat e importit, për periudhën prej 30 ditësh nga data e pagesës së atyre taksave.
11. Motoçikleta.

SHTOJCA B

Shuma e taksës

Pesha e automjetit	Taksa vjetore
Nën 3.5t	40 euro
3,5t dhe mbi 3,5t	90 euro